MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË TRAJTIMIN E STUDENTËVE NR.1 SHA, TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Trajtimin e Studentëve nr. 1 sh.a., Tiranë, me objekt "Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare" për periudhën 01.01.2010 deri më datë 31.12.2011, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 140 datë 30.09.2012.
Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 "Për kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 735/6 datë 30.09.2012, dërguar Z.[redacted], Drejtor i Trajtimin e Studentëve nr. 1 sh.a., Tiranë, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

Organet Drejtuese të SHA Trajtimi i Studentëve nr. 1, nuk kanë evidentuar ndërhyrjet e nevojshme në statut, me qëllim përafrimin e dispozitave të statutit me përcaktimet e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nenin 230 ku citohet se: Shoqëritë tregtare, që kanë ekzistuar, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të detyruara të përshtatin organizimin dhe funksionimin e tyre sipas dispozitave të këtij ligji, brenda tre vjetëve pas hyrjes së tij në fuqi.

Për këtë arsye propozojmë:

Drejtoria të evidentojë ndërhyrjet e nevojshme në statut, në lidhje me emërtimin e shoqërisë dhe kompetencat e organeve drejtuese të shoqërisë dhe të miratojë këto ndryshime në Asamblenë e Aksionarëve, e cila përfaqësohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me qëllim përafrimin e dispozitave të statutit me përcaktimet e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ndryshime të cilat diktohen nga neni 230 dhe nenet 134-167 të cilat rregullojnë shoqëritë aksionare dhe veçanërisht Asamblenë e Përgjithshme, Këshillin Mbikëqyrës dhe Administratorin e Shoqërisë.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Drejtoria dhe Këshilli Mbikëqyrës, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme të funksionimit, përmirësimin e objektivave të përgjithshme, përcaktimin e drejt të aktivitetit dhe rolit të saj, detyrat dhe përgjegjësitë midis departamenteve e zyrave, si dhe të reflektojë ndryshimet në strukturën e shoqërisë.

"Menjëherë"

2. Drejtoria dhe Këshilli Mbikëqyrës, të analizojnë me përgjegjshmëri shkeljet dhe parregullsitë e konstatuara nga KLSH-ja dhe auditi i brendshëm i shoqërisë, si dhe të marrin masa disiplinore dhe administrative ndaj personave përgjegjës.

"Menjëherë"

3. Këshilli Mbikëqyrës të ushtrojë kompetencat e tij, të përcaktuara në Udhëzimin nr. 318, datë 08.04.2009 të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës "Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore", dhe të marrë menjëherë në analizë gjendjen e shoqërisë duke dalë me propozime më konkrete për përmirësimin e gjendjes.

"Menjëherë"

4. Këshilli Mbikëqyrës të miratojë menjëherë strukturën organizative të funksionimit të shoqërisë.

"Menjëherë"

5. Këshilli Mbikëqyrës të analizojë dy herë në vit gjendjen e shoqërisë dhe të marrë në analizë çdo tre muaj aktivitetin e auditit të brendshëm.

"Vazhdimisht"

6. Të hartohen saktë procesverbalet e mbledhjeve, ku të pasqyrohen pjesëmarrja dhe diskutimet e secilit anëtar të Këshillit Mbikëqyrës. Vendimet e marra nga Këshilli Mbikëqyrës, të ndikojnë në përmirësimin e situatës së shoqërisë dhe jo vetëm të jenë vendime rutinë në zbatim të kërkesave të Drejtorisë. Projekt vendimet, urdhrat, udhëzimet etj., të paraqitura për miratim në Drejtori dhe Këshillin Mbikëqyrës t'i nënshtrohen paraprakisht një vlerësimi dhe asistence juridike, nga struktura përkatëse të shoqërisë, me qëllim që vendimet e marra nga organet drejtuese të jenë në formë dhe përmbajtje, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore përkatëse.

"Vazhdimisht"

7. Të miratohet nga strukturat drejtuese të shoqërisë, Drejtoria dhe Këshilli Mbikëqyrës çdo ndryshim në programin ekonomik si dhe miratimin e tyre nga Ministria e Arsimit e Shkencës, për shmangjen e efekteve negative të tejkalimit të numrit të punonjësve dhe fondit të pagave.

8. Të bashkëlidhet urdhër prokurimit për prokurimet me vlera të vogla kërkesa e departamenteve. Të hartohet regjistrin e prokurimeve me vlera të vogla për vitet në vijim.

"Vazhdimisht"

8. Departamenti i Bujtinave të kryej kontrolle të vazhdueshme për kufizimin e përdorimit të energjisë elektrike. Në mënyrë imediate të gjenden zgjidhjet e mundshme për pagesat e energjisë nga përdoruesit familjarë në bujtinat 15A, B, 18 dhe 19 si dhe të krijohen kushte për vënien në punë të kaldajës në masën 100%, për ngrohjen e bujtinave të studentëve.

"Vazhdimisht"

9. Departamenti Teknik, të hartojë sa më saktë kërkesat për nevojat për investime, prokurime me vlera të vogla etj, dhe të zbatojë për çdo shërbim (projektim, kolaudim etj) procedurat e konkurrimit.

"Vazhdimisht"

10. Departamenti i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, të rishikojë strukturën dhe pagat e punonjësve, mundësinë e uljes së numrit të punonjësve, për të arritur një nivel të pranueshëm të shpenzimeve, i cili pasqyrohet në kostot operative. Të ndjekë zbatimin e numrit mesatar të punonjësve dhe pagës mesatare të programuar nga METE.

"Vazhdimisht"

11. Të hartojë në bashkëpunim me departamentet kërkesat për rekrutimin e punonjësve, për çdo pozicion pune. Të kufizojë lëvizjet e shumta të brendshme të punonjësve si dhe largimet nga puna pa shkaqe të përligjura.

"Menjëherë"

12. Të përmirësohet metodologjia e hartimit të programeve të zhvillimit ekonomiko-financiar; të bëhen analiza dhe vlerësime të hollësishme ekonomiko-financiare në mënyre që të shmangen në maksimum ndryshimet e pjesshme të programit të zhvillimit, regjistri i parashikimit të prokurimeve të jetë pjesë përbërëse e programit ekonomik, për të mos krijuar shkëputje në realizimin e programit të investimeve dhe shërbimeve.

"Vazhdimisht"

13. Të kryhen studime dhe analiza për aktivitetin e dhënies me qira të bujtinave për familjarët, me qëllim përmirësimin e treguesve të të ardhurave, si dhe të veçohen nga vlera e qirasë shpenzimet e energjisë elektrike dhe ujit të pijshëm.

"Menjëherë"

14. Këshilli Mbikëqyrës, MASH dhe METE të ushtrojnë kompetencat e tyre për të gjetur zgjidhjet e mundshme për emërimin në punë sipas vendimit të gjykatës të ish drejtorit z. Astrit Kola, pasi moszbatimi i vendimit të gjykatës i ka kushtuar shoqërisë pagesa të tepërta të barabarta me pagën e drejtorit të drejtorisë së shoqërisë për periudhën 13.06.2006 e në vazhdim.

"Menjëherë"

15. Të përgatitet dokumentacioni teknik për hipotekimin e trojeve në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, sipas kërkesave të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ndryshuar me ligjin nr. 9407, datë 19.5.2005, për të eleminuar keq menaxhimin e tyre.

"Menjëherë"

16. Drejtoria Ekonomike të përgatisë dhe të miratoj në strukturat drejtuese të shoqërisë një dokument ku të përshkruaj organizmin dhe procedurat kontabël, i cili është i nevojshëm për kuptimin e sistemit të trajtimit të informacionit kontabël dhe të kryerjes së kontrollit.

"Menjëherë"

17. Shoqëria të llogarisë provizione për llogaritë e arkëtueshme afatshkurtra, "Të drejta dhe detyrime për zhdëmtime" **në shumën 4, 658, 054 lekë,** arkëtimi i të cilave është i pa mundur.

"Menjëherë"

18. Shoqëria të saktësojë aktivet financiare afatshkurtra **në shumën 5,904,123** lekë, paraqitura në postin "të tjera nga persona dhe personeli", e cila është e mbartur nga vitet e kaluara dhe është e pa detajuar, të llogarisë provizion për këtë shumë, pasi arkëtimi i të cilave është i pa mundur.

"Menjëherë"

19. Të saktësohet posti "inventar i imët" **në shumën 34,056,930 lekë** i pasqyruar në inventarin qarkullues, pasi ky grup ka jetëgjatësi më të madhe se viti ushtrimor dhe duhet të klasifikohet në grupin e aktiveve afatgjata materiale, duke aplikuar normat e amortizimit që i takojnë këtij grupi.

"Menjëherë"

20. Të saktësohet gjendja e lartë e "lëndëve të para" në fund të vitit 2011 **në vlerën 16,486,483 lekë** e cila është e pa justifikuar me objektin e veprimtarisë dhe krijon risk për shoqërinë.

"Menjëherë"

21. Drejtoria dhe Këshilli Mbikëqyrës, të analizojnë detyrimet debitore të cilat për vitet 2010-2011 janë përkatësisht **në vlerën 102,619,770 lekë.**

Drejtoria dhe Këshilli Mbikëqyrës, të analizojnë detyrimet ndaj furnitorëve e kreditorëve gjendja e së cilës në fund të viteve 2010-2011 është përkatësisht **në vlerat 20,422,38 lekë dhe 25,794,021 lekë.**

"Menjëherë"

22. Të derdhen në buxhetin e shtetit të ardhurat e krijuara nga dhënia me qira ose enfiteozë e objekteve **në vlerën 12,082,566 lekë**, pasi shpërndarja e të ardhurave nga qiratë nuk është bërë konform Kapitullit VI të VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 "Për dhënien me qira ose Enfiteozë të Pasurive të Ndërmarrjeve, Shoqërive dhe Institucioneve Shtetërore", i cili përcakton se, të ardhurat, që krijohen nga dhënia me qira ose enfiteozë ndahen, 70 % Buxheti i Shtetit; dhe 30%, ndërmarrja, shoqëria apo institucioni shtetëror, që ka në administrim objektin e dhënë me qira.

"Menjëherë"

23. Komisioni i prokurimeve me vlera të vogla, në mbështetje të detyrave të përcaktuara në pikën 5 të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 18.02.2008, në kushtet e zbatimit të Urdhrave të Prokurimit e të procedurave të blerjeve dhe të administrimit të faturave të mallrave apo shërbimeve, të mbajë regjistër për mallrat (ose grup mallrash) apo shërbimeve të realizuara me ketë procedurë për vitet në vijim, si dhe të kufizohet numri i rasteve të kryerjes së blerjeve me arkë.

"Vazhdimisht"

24. Të rishikohet struktura e hartuar nga Drejtoria për ngarkesën e punës të çdo Departamenti në mbështetje të VKM nr. 474, datë 16.06.2011 "Për përcaktimin e standardeve e të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike".

"Menjëherë"

25. Autoriteti Kontraktor në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik, të marrë masa për trajnimin e punonjësve në fushën e prokurimeve publike si dhe njohjen e azhurnimin e tyre, me ndryshimet e legjislacionit në këtë fushë**.**

"Vazhdimisht"

26. Të dokumentohen nga autoriteti kontraktor kryerja e analizave të kostos së mallrave dhe shërbimeve që do të prokurohen, duke krahasuar me specifikimet teknike.

"Vazhdimisht"

27. Autoriteti Kontraktor të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim që të sigurojnë konkurrencën e nevojshme si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punimeve për të arritur rezultate të dëshirueshme e efektivitet në përdorimin e fondeve publike.

"Vazhdimisht"

28. Të likuidohen nga autoriteti kontraktor faturat e kontraktueseve konformë me Kushtet e Veçanta të Kontratës neni 6 "Kushtet e Pagesës" pika 6.1, pasi moszbatimi i kontratave të punëve, mallrave dhe shërbimeve për vitet 2010, 2011 e në vijim krijon risk për pagesa të tepërta.

"Vazhdimisht"

29. Ti kushtohet vëmendje e duhur nga titullari i autoritetit kontraktor ose i ngarkuari i tij shqyrtimi dhe vlerësimi nga KVO-ja i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të

ofertuesve, pasi në disa procedura shqyrtimi dhe vlerësimi nuk është korrekt dhe ka lënë hapësira për qëndrime subjektive. Autoriteti kontraktor të ngrejë komisione me specialistë dhe ekspertë të fushës, për kolaudimin e mallrave, shërbimeve dhe punimeve.

"Vazhdimisht"

30. Të hartohet sipas manualit grafiku i punimeve të ndërtimit, pasi në dokumentet e tenderave të zhvillura gjatë viteve 2010-2011 nuk janë përcaktuar njësitë e matjes, vëllimi i punës, ditë-njerëz, specialist punëtor, për pasojë afati i përcaktuar në kontratë nuk është i argumentuar.

"Vazhdimisht"

31. Të kërkohet nga autoriteti kontraktor në çdo kontratës pune ose shërbimi sigurimi i objektit nga kontraktori, me afat nga data e hyrjes në kantier deri në afatin e realizimit së plotë të kontratës i cili të mbulojë kompensimin e kërkuar për humbjet ose dëmtimet e shkaktuara, konformë nenit 25 "Sigurimi i kushteve të përgjithshme të kontratës, pika 25.1, 25.2 dhe 25.3".

"Vazhdimisht"

32. Të plotësohen me dokumentacion dosjet e kontratave të ambienteve të dhëna me qira konformë VKM nr. 529, datë 08.06.2011 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", ku përcaktohen kriteret dhe dokumentacioni që duhet të plotësohet për objektet e dhëna me qira apo enfiteozë të ndërmarrjeve shtetërore, paragrafi II pika 4.

"Vazhdimisht"

33. Ti kushtohet vëmendje e duhur procesit të ndjekjes së rekomandimeve nga auditimi i brendshëm, duke synuar jo vetëm përcaktimin e dëmit të shkaktuar apo përgjegjësive, por mbi të gjitha përmirësimin dhe parandalimin e përsëritjen e fenomeneve të tilla në të ardhmen.

"Vazhdimisht"

34. Drejtoria të njoftojë Inspektoriatin e Ndërtimit pranë Bashkisë Tiranë dhe Inspektoriatin Ndërtimor Urbanistik Kombëtar për prishjen e ndërtimeve pa leje në territorin e "Trajtimit të Studentëve Nr.1 Sh.a".

"Menjëherë"

35. Drejtoria dhe Këshilli Mbikëqyrës të shikojnë mundësinë e zgjerimit të projektit "internet falas në godinat e studentëve", duke e përfshirë këtë nisëm në programet e zhvillimit ekonomiko financiar, në vitet në vijim.

"Menjëherë"

C. MASA ADMINISTRATIVE

Referuar parregullsive dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e prokurimeve të zhvilluara për vitet 2010-2011, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar për çdo procedurë, bazuar në nenin 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe pikës 3, kreut X të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar, i kërkojmë Agjencisë së Prokurimit Publik **të vlerësojë shkeljet e konstatuara,** duke rekomanduar marrjen e masave administrative e disiplinore për punonjësit si më poshtë:

1. zj. [redacted] në cilësinë e Juristes në Njësinë e Prokurimit;

2. zj. [redacted] me detyrë Drejtor i Shërbimeve Teknike, në cilësinë e specialistes në Njësinë e Prokurimit;
3. znj. [redacted], me detyrë Ekonomiste Page, në cilësinë e specialistes në Njësinë e Prokurimit, dhe
4. z [redacted], Administrator në bujtinën nr. 14, në cilësinë e specialistit në Njësinë e Prokurimit.

Për arsye se:
- Nuk kanë përcaktuar saktë në dokumentet e tenderit dëshmitë/dokumentet të cilat duhet të paraqesin operatorët ekonomik që të vlerësohen të suksesshëm.
- Nuk kanë përcaktuar në dokumentet e tenderit klasën dhe kategorinë e licencës personale të shoqërisë dhe stafit kryesor përgjegjës për zbatimin e kontratës.
- Kërkesat e veçanta për kualifikim për: kapacitetin ekonomik dhe financiar, të operatorëve ekonomik, janë të ekzagjeruara, si rrjedhojë e kërkesave të tilla autoriteti kontraktor ka paguar më shumë për diferencat në kualifikimin e ofertuesve, në kundërshtim me nenet 46 e 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", ku përcaktohet se kriteret kualifikuese duhet të jenë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese.
- Kanë kërkuar në dokumentet e tenderit kërkesat e veçanta për kualifikim dokumente/dëshmi, në kundërshtim me pikat 5 dhe 8 të nenin 43 "Afatet kohore për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje dhe për dorëzimin e ofertave" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik".

5. znj. [redacted], me detyrë Drejtore e Departamentit Ekonomik, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave;
6. z. [redacted], me detyrë specialist në Departamentin Ekonomik në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, dhe
7. znj. [redacted], në cilësinë e anëtares së komisionit të vlerësimit të ofertave.

Për arsye se:
- Kanë kualifikuar operatorin ekonomik/ofertuesit, në kundërshtim me nenin 53, pika 3 e LPP, kreut V, pika 4, e RRPP dhe DT "kërkesat e pranim/kualifikimit".
- Nuk kanë dokumentuar zbatimin e nenit 56 LPP, kreut V pika 4/ë të RPP dhe DT në përllogaritjen e ofertës anomalisht të ulët.

Këto shkelje janë konstatuar në procedurën me objekt:
-"Lyerje godinave qyteti i studentit", me vlerë limit të kontratës 6,667 mijë lekë, pa TVSh, zhvilluar më datë 28.05.2010;
-"Rikonstruksion i godinës 22", me vlerë limit të kontratës 27,500 mijë lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 19.07.2010;
- "Rikonstruksion i godinës 23", me vlerë limit të llogaritur të kontratës 28,333 mijë leke pa tvsh, zhvilluar më datë 19.07.2010;
- "Blerje materiale ndërtimi", me vlerë të përllogaritur të kontratës 3,750 mije lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 19.05.2011;
-"Blerje mobilierie", me vlerë të përllogaritur e kontratës 12,916 mije lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 05.07.2011;

- “Furnizim me dyshek për Qytetin Studenti”, me vlerë të përllogaritur të kontratës 12,500 mije lekë pa tvsh, zhvilluar më 29.08.2011
-“Lyerje fasade të god. 4, 6, 13”, me vlerë të përllogaritur e kontratës 2,333 mije lekë pa tvsh, zhvilluar në datë 24.06.2011;
- “Ndërtim muri mbajtës, rrethues mbrapa godinave 22 dhe 23 të Qytetit Studenti”, me vlerë të përllogaritur e kontratës 2.500 mije lekë pa tvsh zhvilluar më datë 30.11.2011;
-“Lyerje godinave qyteti i studentit”, me vlerë të përllogaritur e kontratës pa TVSh 6,667 mije lekë, zhvilluar më datë 17.06.2011;
- “Ndërtimi i sistemit me ujë në dhomat e godinave 6 dhe 14 të Qytetit” Studenti, me vlerë të përllogaritur të kontratës 9, 000 mije lekë pa tvsh zhvilluar më datë 17.06.2011;
- “Blerje karburanti”, me vlerë të përllogaritur të kontratës 1,667mijë lekë pa tvsh;
- “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”, me vlerë të përllogaritur të kontratës 3,750 mijë lekë, dhe
- “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”, me vlerë të përllogaritur të 4,167 mijë lekë.
Trajtuar më hollësisht në faqet 44-80, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për ish punonjësin z. [redacted], me detyrë ish zv/ drejtor, në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave
Nuk rekomandojmë masa disiplinore dhe administrative sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi punonjësi i sipërpërmendur nuk është në marrëdhënie pune me këtë shoqëri dhe nuk ka adresim institucional për dhënien, ndjekjen e zbatimin e tyre.

Ç. MASA DISIPLINORE

a. Ministri i Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministri i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe Statutin e shoqërisë, të marrin masat disiplinore:

“Shkarkim nga detyra”

1. zj. [redacted], në cilësinë e kryetares së këshillit mbikëqyrës;
2. zj. [redacted], në cilësinë e anëtares së këshillit mbikëqyrës, dhe
3. zj. [redacted], në cilësinë e anëtares së këshillit mbikëqyrës.

Për arsye se:

Dokumentacioni miratuar për procedurat e zhvilluar nga METE për dhënien me qira të objekteve: “Ambient pranë godinës 13”, me sipërfaqe të përgjithshme 311 m², prej nga 100 m² është sipërfaqe nën objekt dhe 211 m² sipërfaqe funksionale dhe “Ambient pranë godinës 12”, me sipërfaqe të përgjithshme 325 m², prej nga 96 m² është sipërfaqe nën objekt dhe 229 m² sipërfaqe funksionale, nuk është bërë konform përcaktimit të pikës 1 të kreut I dhe pikës 1/c të kreut II, të VKM-së nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, dhe udhëzimeve të METE-së, për arsye se për procedurat e cituar

më sipër nuk janë përcaktuar saktë sipërfaqet në objekt, si dhe miratimi i propozimeve të Trajtimit të Studentëve Nr,1 SHA për dhënien me qira ose enfiteoze të pronës shtetërore, është bërë pa miratim nga ministria e linjës administrative MASH.

b. Prefekti i Prefekturës së Qarkut Tiranë bazuar në ligjin nr. 8209, datë 22.4.1997 "Për disa ndryshime në ligjin nr.7608, datë 22.9.1992 "Për prefekturat", dhe dispozitat nënligjore të dala në zbatim të tij, të marrin masat disiplinore:

"Largim nga puna", për

zj. [redacted], arkitekte, në cilësinë e përfaqësueses së Prefekturës së Qarkut Tiranë.

Për arsye se:
Genplanet e objekteve të konfirmuar nga zj. Flutura Pojani, me shkresën nr. 1456/1, date 21.06.2011 e Prefektit të Qarkut Tiranë për procedurat e zhvilluar nga METE për dhënien me qira të objekteve: "Ambient pranë godinës 13", me sipërfaqe të përgjithshme 311 m², prej nga 100 m² është sipërfaqe nën objekt dhe 211 m² sipërfaqe funksionale dhe "Ambient pranë godinës 12", me sipërfaqe të përgjithshme 325 m², prej nga 96 m² është sipërfaqe nën objekt dhe 229 m² sipërfaqe funksionale, nuk janë bërë konform përcaktimit të pikës 1 të kreut I dhe pikës 1/c të kreut II, të VKM-së nr. 529, datë 08.06.2011 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", dhe udhëzimeve të METE-së, për arsye se për procedurat e cituara më lartë nuk janë përcaktuar saktë sipërfaqet në objekt.

c. Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike pranë Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, të analizojë Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe për shkeljet e cilësuara në këtë raport, ndaj drejtueseve dhe specialistëve të Sektorit të Qirave dhe Monitorimit të Kontratave të Qirave të merren masat disiplinore përkatëse.

Për arsye se:

Dokumentacioni për procedurat e zhvilluar nga METE për dhënien me qira të objekteve: "Ambient pranë godinës 13", me sipërfaqe të përgjithshme 311 m², prej nga 100 m² është sipërfaqe nën objekt dhe 211 m² sipërfaqe funksionale dhe "Ambient pranë godinës 12", me sipërfaqe të përgjithshme 325 m², prej nga 96 m² është sipërfaqe nën objekt dhe 229 m²sipërfaqe funksionale, nuk është plotësuar konform përcaktimit të pikës 1 të kreut I dhe pikës 1/c të kreut II të VKM-së nr. 529, datë 08.06.2011 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", dhe udhëzimeve të METE-së, sepse për procedurat e cituara më sipër, nuk janë përcaktuar saktë sipërfaqet në objekt si dhe dhënia me qira ose enfiteoze të pronës shtetërore, është bërë pa miratim nga ministria e linjës administrative MASH.

d. Duke analizuar të gjitha parregullsitë dhe shkeljet e konstatuara dhe evidentuara gjatë auditimit të ushtruar në Trajtimin e Studentëve Nr.1 SHA dhe duke marrë në

konsiderate kërkesat ligjore të përcaktuara në dispozitat që rregullojnë veprimtarinë në fushën e kontabilitetit, të administrimit të pronës, etj., bazuar në Rregulloren Brendshme, Kontratën Individuale të Punës, kërkojmë nga Drejtoria të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

"Largim nga puna"

zj. [redacted] , me detyrë Juriste

Për arsye se:

- Në objektet e të dhëna me qira janë konstatuar mungesa në plotësimin e dokumentacionit nga ana e qiramarrësve si: mungon miratimi nga ministria e linjës administrative, nuk kanë paraqitur kontratën me Ujësjellës Kanalizimet SHA, Tiranë; mungon kontrata me CEZ Shpërndarje; mungon vërtetimi nga dega e tatim taksave; mungon certifikata e regjistrimit në QKR si dhe NUIS-i; mungojnë vërtetimet nga organet dhe institucionet përkatëse se subjekti nuk është në ndjekje penale dhe se nuk ka proces gjyqësor lidhur me veprimtarinë ekonomike.

-Dokumentacioni i hartuar për procedurat e zhvilluar nga METE për dhënien me qira të objekteve: "Ambient pranë godinës 13", me sipërfaqe të përgjithshme 311 m², prej nga 100 m² është sipërfaqe nën objekt dhe 211 m² sipërfaqe funksionale dhe "Ambient pranë godinës 12", me sipërfaqe të përgjithshme 325 m², prej nga 96 m² është sipërfaqe nën objekt dhe 229 m² sipërfaqe funksionale, nuk është bërë konform përcaktimit të pikës 2, kreu I dhe pikës 1/c të kreut II, të VKM-së nr. 529, datë 08.06.2011 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", dhe udhëzimeve të METE-së, pasi për procedurat e cituar më sipër, nuk janë përcaktuar saktë sipërfaqet në objekt dhe funksionale, si dhe dhënia me qira ose enfiteoze të pronës shtetërore, është bërë pa miratim nga ministria e linjës administrative MASH.

e. Duke analizuar të gjitha parregullsitë dhe shkeljet e konstatuara dhe evidentuara gjatë auditimit të ushtruar në Trajtimin e Studentëve Nr.1 SHA dhe duke marrë në konsiderate kërkesat ligjore të përcaktuara në dispozitat që rregullojnë veprimtarinë në fushën e kontabilitetit, të administrimit të pronës, etj., bazuar në Rregulloren Brendshme, Kontratën Individuale të Punës, kërkojmë nga Drejtoria të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

"Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna"

zj. [redacted], me detyrë Drejtore e Departamentit Ekonomik.

Për arsye se:

- Nuk ka llogaritur provigjone për llogaritë e arkëtueshme afatshkurtra, "Të drejta dhe detyrime për zhdëmtime" në shumën 4, 658, 054 lekë, arkëtimi i të cilave është i pa mundur.
- Ka paraqitur në "aktive financiare afatshkurtra" shumë 5,904,123 lekë, tek "Të tjera nga persona dhe personeli", e cila është e mbartur nga vitet e kaluara dhe është e pa detajuar, nuk ka llogaritur provigjon për këtë shumë arkëtimi i të cilave është i pa mundur.
- Ka paraqitur në postin "inventar i imët" shumë 34,056,930 lekë të cilën e pasqyron e inventarit qarkullues.
- Nuk ka arkëtuar detyrimet debitore të cilat për vitet 2010-2011 janë në përkatësitë vlerën 102,619,770 lekë.
- Nuk ka paguar detyrimet ndaj furnitorëve e kreditorëve gjendja e së cilës në fund të viteve 2010-2011 është përkatësisht 20,422,38 lekë 25,794,021 lekë.
- Nuk ka derdhur në buxhet vlerën 12,082,566 lekë e llogaritur deri më 11.08.2011, sipas Kapitullit VI të VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 "Për dhënien me qira ose Enfiteozë të Pasurive të Ndërmarrjeve, Shoqërive dhe Institucioneve Shtetërore".

e. Duke analizuar të gjitha parregullsitë dhe shkeljet e konstatuara dhe evidentuara gjatë auditimit të ushtruar në Trajtimin e Studentëve Nr.1 SHA dhe duke marrë në konsiderate kërkesat ligjore të përcaktuara në dispozitat që rregullojnë veprimtarinë në fushën e kontabilitetit, të administrimit të pronës, etj., bazuar në Rregulloren Brendshme, Kontratën Individuale të Punës, kërkojmë nga Drejtoria të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

"Vërejtje me shkrim"

1. z. [redacted], në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Kolaudimit
2. z. [redacted], në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Kolaudimit
3. zj. [redacted], në cilësinë e anëtares së Komisionit të Kolaudimit
4. zj. [redacted], në cilësinë e anëtares së Komisionit të Kolaudimit

Për arsye se:
Në akt kolaudimin e datës 17.10.2011, nuk është marrë në konsideratë dokumenti datë 22.06.2011 me objekt: Shtojcë mbi modifikimin e dokumentacionit standard të prokurimit me objekt: Furnizim me dyshekë për Qytetin Studenti" në të cilin janë kërkuar që dyshekët të plotësojnë specifikimet: Filtro 1000 gr m², Ovate 1000 gr m², Korniza 7/22, susta ¢ 2.2 Stofi i cilësisë së lartë 300 gr/ m² dhe jo TNT dhe Stofi të jetë i trapontuar me ovaten së bashku.

Lista me emrat e lartpërmendur do t`i dërgohet Departamentit të Administratës Publike (DAP)

D. KALLZIM PENAL

Bazuar në Kodin Penal, neni 248 "Shpërdorimi i detyrës" propozojmë të bëhet kallëzim penal pranë organeve të prokurorisë, ndaj:

1. **zj. [redacted], në cilësinë e ish kryetares së Këshillit Mbikëqyrës të "Trajtimit të Studentëve Nr.1 Sh.a" , Tiranë.**
2. **zj. [redacted], në cilësinë e anëtares së Këshillit Mbikëqyrës të të "Trajtimit të Studentëve Nr.1 Sh.a" , Tiranë.**
3. **zj. [redacted], në cilësinë e anëtares së Këshillit Mbikëqyrës të "Trajtimit të Studentëve Nr.1 Sh.a" , Tiranë.**

Për shkeljet e konstatuara, lidhur me dhënien me qira të objekteve: "Ambient pranë godinës 13", me sipërfaqe të përgjithshme 311 m², prej nga 100 m² është sipërfaqe nën objekt dhe 211 m² sipërfaqe funksionale dhe "Ambient pranë godinës 12", me sipërfaqe të përgjithshme 325 m², prej nga 96 m² është sipërfaqe nën objekt dhe 229 m² sipërfaqe funksionale.

Nga auditimi i dokumenteve të paraqitura konstatohet se dhënia me qira nuk është bërë konform përcaktimit të pikës 1 kreut II, të VKM-së nr. 529, datë 08.06.2011 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", për arsye se nuk është marrë paraprakisht miratimi i organit të varësisë administrative që në këtë rast është Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Shefki Jaupi, Nefail Xhepexhiu**,** Mimoza Bedini**,** Lavdie Fshazi, Andi Buzo më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Athanas Karaja, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Erjon Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT